

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8279  
E shtunë, 11 prill 2026  
Çmimi 0.50 €

Haradinaj: Jo ndoshta,  
por jemi në zgjedhje



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BURIM RAMADANI

## NA DUHET TË KEMI PRESIDENT, NUK NA DUHEN ZGJEDHJE

**- Kosova është zhytur në amulli politike.  
Arritja e konsensusit për zgjedhjen  
e presidentit nuk duket se është afër**

Njohësi i çështjeve politike dhe të sigurisë, Burim Ramadani, ka vlerësuar se Kosovës i duhet një president i ri dhe jo zgjedhje të reja parlamentare. Në këtë kontekst, Ramadani ka thënë se arritja e konsensusit për zgjedhjen e presidentit nuk duket se është afër. Në këtë intervistë për "Epokën e re", ai ka thënë se përgjegjësia për zgjedhjen e presidentit u takon partive të mëdha në vend. Ramadani ka vlerësuar se Kosova është zhytur në amulli politike. Ai ka theksuar se mungesa e stabilitetit politik e institucional tash e gati dy vjet është duke cenuar funksionimin e shtetit.

Krahas kësaj, Ramadani ka kritikuar edhe opozitën e cila, sipas tij, nuk është e strukturuar. Ndërsa sa i përket procesit gjyqësor në Hagë, Ramadani ka shprehur bindjen se liderët e UÇK-së do të shpallen të pafajshëm. "Jam i bindur se lirimi i të akuzuarve në Hagë do të paraqesë një moment kthese pozitive për Kosovën, historinë dhe të vërtetën tonë, sikurse edhe ta kthejë besimin publik për proceset", ka thënë Ramadani



### AKTUALE



**KURTI NË LONDËR TAKOHET  
ME MINISTRIN E SHTETIT PËR  
MBROJTJE, FLASIN PËR  
BASHKËPUNIMIN USHTARAK** F. 7

**HYJNË NË FUQI RREGULLAT E  
REJA TË UDHËTIMIT NË BE** F. 2

**MBYLLEN DY ORDINANCA  
NË VENDBANIMET ME SERBË  
NË SKENDERAJ** F. 6

### EKONOMI



**OEAK-u KËRKON REFORMA  
URGJENTE, PARALAJMËRON  
RREZIQE NGA PASIGURIA  
POLITIKE DHE MUNGESA E  
VENDIMEVE FISKALE** F. 8

**RRITJA E ÇMIMEVE VAZHDOI  
EDHE GJATË MARSIT** F. 8

### SPORT

XHIRO 28		
PRISHTINA E RE	15:00	MALISHEVA
BALLKANI	15:00	DJILANI
GRITA	15:00	PERIZAJ
LLAPI	15:00	ORENIDA
PRISHTINA	15:00	DIKADJINI

**SOT DHE NESËR LUHEN NDESHJET  
E JAVËS SË 28 NË SUPERLIGË** F. 11



**KUVENDI MIRATON  
REZOLUTËN  
E PDK-SË PËR TË  
VËRTETËN DHE  
DINJITETIN E VIKTIMAVE  
TË LUFTËS** F. 2



**PROTESTA  
E STUDENTËVE NË  
PEJË: E TURPESHME  
TA MBROJMË  
UÇK-në NGA  
SHQIPTARËT** F. 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# HYJNË NË FUQI RREGULLAT E REJA TË UDHËTIMIT NË BE

**BRUKSEL, 10 PRILL** - Sistemi i ri i hyrje-daljeve (EES) i Bashkimit Evropian ka hyrë në fuqi zyrtarisht të premten. Ky sistem vlen për qytetarët që nuk janë shtetas të bllokut evropian. EES-ja është sistem i digjital që zëvendëson vulosjen manuale të pasaportave për qytetarët e të ashtuquajturave vende të treta kur hyjnë në zonën Shengen. Ky sistem regjistron të dhëna biometrike - gjurmët e gishtërinjve dhe imazhin e fytyrës si dhe të dhëna personale dhe të dhëna udhëtimi, me qëllim përmirësimit e sigurisë kufitare, zbulimin e atyre që tejkalojnë afatin e qëndrimit dhe parandalimin e vjedhjes së identitetit.

Sistemi EES do të zbatohet për qytetarët që mbajnë pasaporta biometrike, pavarësisht nëse u duhet vizë për të hyrë në BE apo jo. Zbatimi i pjesshëm i këtij sistemi kishte filluar në tetor të vitit 2025. Për zyrtarët e Komisionit Evropian, ky është sistemi më modern në botë që ka treguar tashmë rezultate konkrete. "Me sistemin e hyrje-daljeve, ne po ndërtojmë sistemin kufitar më modern të IT-së në

botë. Dhe tashmë po i shohim rezultatet në pesë muajt e fundit. Janë regjistruar më shumë se 45 milionë hyrje dhe dalje. Ka pasur më shumë se 24.000 refuzime hyrjeje, nga të cilat mbi 600 njerëz janë identifikuar si kërcënim për sigurinë e bllokut tonë. Pra, kjo tregon vërtet se po funksionon për qëllimin për të cilin u miratua fillimisht", ka thënë Arianna Podesta, zëdhënëse e Komisionit Evropian.

Megjithatë, disa shtete anëtare tashmë po përballen me probleme teknike. Belgjika, përveç Francës dhe Holandës, për shembull, e kishte njoftuar tashmë Komisionin Evropian se sistemi nuk do të ishte plotësisht funksional në të gjitha pikat kufitare deri në afatin e caktuar ligjor, përkatësisht më 10 prill. Këto vende janë përballur me radhë pasagjerësh në aeroporte në muajt e fundit, të cilat në disa raste kanë rezultuar në pritje prej disa orësh në pikat kufitare. Zëdhënësjja Podestes, ka konfirmuar se Komisioni Evropian ka qenë në kontakt me vendet që përballen me probleme, duke ndarë praktikat më të mira nga ato shtete anëtare



ku sistemi po funksionon shumë mirë. Zyrtarët kompetentë të Komisionit Evropian pohojnë se duhen mesatarisht 70 sekonda për të regjistruar një hyrje ose dalje. Megjithatë, lejohet fleksibilitet për të siguruar rrjedhën e qetë të kufijve, veçanërisht duke pasur parasysh sezonin e verës kur pritet lëvizje e shtuar. Ky fleksibilitet do të jetë i mundur vetëm gjatë muajve të pushimeve verore. "Rregullat u lejojnë shteteve anëtare të

pezullojnë regjistrimin e të dhënave biometrike, në një farë mënyre për të pezulluar pjesërisht funksionimin e EES, në rast të kohës së tepërt të pritjes. Kjo mundësi ekziston deri në shtator, duke mbuluar kështu periudhën e verës kur mund të pritet rritje e trafikut", ka thënë Podesta.

Sistemi EES shihet si një mënyrë për të siguruar sigurinë e kufijve të BE-së. Udhëtarët që qëndrojnë më gjatë se afati i lejuar i

qëndrimit të tyre në BE (90 ditë në një periudhë 180-ditore) konsiderohen se qëndrojnë jashtëligjësisht në Zonën Shengen dhe do t'iu nënshtrohen një procedure kthimi. Sipas rregullores së Komisionit Evropian, vendimet për kthim në raste të caktuara do të shoqërohen me një ndalim hyrjeje (kur nuk është dhënë një periudhë për largim vullnetar ose kur detyrimi për t'u kthyer nuk është përmbushur), ndërsa në raste të tjera mund të vendoset edhe një ndalim hyrjeje.

Si ndalimet e hyrjes ashtu edhe vendimet e kthimit do të regjistrohen në sistemin EES. Kohëzgjatja e ndalimit të hyrjes do të përcaktohet duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse të rastit individual dhe, si rregull, nuk do të kalojë pesë vjet. Nëse personi ndaj të cilit zbatohet ndalimi përpikët të kalojë përsëri kufirin Shengen, hyrja do t'i refuzohet në kufi dhe të dhënat e refuzimit do të regjistrohen në sistem. Në raste të caktuara, parashikohet edhe mundësia e pavlefshmërisë së pasaportës pas përpjekjes për hyrje.

## NETANYAHU I BINDET TRUMPIT PËR LIBANIN



**UASHINGTON, 10 PRILL** - Presidenti amerikan Donald Trump raportohet se i ka kërkuar kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu t'i ngadalësojë sulmet izraelite ndaj Libanit pasi po rrezikonte armëpushimin e brishtë me Iranin. Sipas "NBC News", duke cituar një zyrtar të lartë të afërt me Trumpin, kërkesa ka ardhur gjatë një bisede telefonike, pak pasi Netanyahu kishte premtuar publikisht se do të vazhdonte sulmet ndaj Libanit.

Zëvendëspresidenti amerikan, JD Vance, ka deklaruar se Izraeli kishte rënë dakord të "kontrollonte veprimet e tij" në lidhje me Libanin për të ndihmuar negociatat me Iranin, shkruan timesofisrael. Megjithatë, të enjten është regjistruar fushata e bombardimeve më e madhe izraelite në Liban që nga fillimi i luftës me Iranin, pa ndonjë tregues se Jerusalem kishte rënë dakord të tregonte përmbajtje. Ndërkohë, Forcat Ajrore Izraelite

kanë vazhduar bombardimet ndaj Libanit, megjithëse me një intensitet pak më të ulët se dita e mëparshme.

Në një përditësim këtë mëngjes, Ushtria Izraelite (IDF) ka njoftuar se kishte goditur depot e armëve, lëshuesit e raketave dhe selitë e Hezbollahut në jug të Libanit. Izraeli dhe ShBA-ja kanë pretenduar se Libani nuk mbulohet nga armëpushimi me Iranin, ndërsa Teherani dhe ndërmjetësit pakistanezë kanë insistuar për të kundërtën.

## ShBA-ja i bën thirrje Irakut t'i parandalojë sulmet nga grupet e lidhura me Iranin

**UASHINGTON, 10 PRILL** - Departamenti Amerikan i Shtetit ka njoftuar se ka ftuar në takim ambasadorin e Irakut për t'i dënuar "sulmet e rënda terroriste" nga grupe të armatosura të mbështetura nga Irani ndaj interesave amerikane në Irak. Shtetet e Bashkuara "nuk do të tolerojnë sulme ndaj interesave të tyre dhe presin që Qeveria irakiane t'i ndërmarrë menjëherë të gjitha masat për t'i shpërbërë grupet e milicive të lidhura me Iranin në Irak", ka thënë zëdhënësi Tommy Pigott në një deklaratë.

Pigott ka thënë se zëvendëssekretari i Shtetit, Christopher Landau në takim me ambasadorin irakian, Nazar Al-Khirullah, ka deklaruar "dënimin e fortë" të qeverisë amerikane për sulmet, "përfshirë një pritë më 8 prill ndaj diplomatëve amerikanë në Bagdad".

Ai nuk ka dhënë hollësi të tjera mbi rreth pritës së supozuar. Iraku është përfshirë në konfliktin mes Shteteve të Bashkuara, Izraelit dhe Iranit, pasi kishte sulme të vazhdueshme ndaj interesave

amerikane, veçanërisht në Ambasadën amerikane në Bagdad. Grupet e armatosura proiraniane kanë njoftuar të mërkurën se do t'i pezullonin sulmet e tyre për dy javë, pas shpalljes së armëpushimit midis Shteteve të Bashkuara dhe Iranit. "Derisa i njohu përpjekjet e forcave të sigurisë irakiane për t'iu përgjigjur këtyre sulmeve terroriste, zëvendëssekretari theksoi dështimin e Qeverisë irakiane për t'i parandaluar ato", ka thënë Pigott. Ai ka thënë se marrëdhëniet



ShBA-Irak janë ndikuar negativisht nga fakti se "disa elementë të lidhur me qeverinë

irakiane vazhdojnë të ofrojnë mbulim politik, financiar dhe operacional për milicite".

# KUVENDI MIRATON REZOLUTËN E PDK-së PËR TË VËRTETËN DHE DINJITETIN E VIKTIMAVE TË LUFTËS

Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën për të vërtetën dhe dinjitetin e viktimave të luftës. Kjo rezolutë është miratuar me 90 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Rezoluta e miratuar në Kuvend është propozuar nga PDK-ja pas ekspozitës me pasaktësi mbi masakrat në Kosovë. Me këtë rast, PDK-ja ka falënderuar të gjithë deputetët që kanë votuar këtë rezolutë, duke dëshmuar përgjegjësi dhe respekt për të vërtetën historike dhe dinjitetin e viktimave të luftës

EPOKA  
E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 PRILL - Me 90 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar një rezolutë, e cila kërkon të mbrohet "e vërteta historike e luftës në Kosovë më 1998-1999". Rezoluta është propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), pas ekspozitës së mbajtur në sheshin e Prishtinës në muajin mars, mbi masakrat në Kosovë, e cila kishte të dhëna të pasakta. Deputeti i PDK-së, Nait Hasani, ka lexuar tekstin e rezolutës, ku është dënuar shtrembërimi, relativizimi apo paraqitja e pasaktë e fakteve që lidhen me luftën e fundit në Kosovë. "Rezoluta dënon nismat, si ekspozita e fundit e organizuar në hapësirat publike në Prishtinë që me pasaktësi

mbi të dhënat për masakrat në Kosovë nxisin reagime të gjera dhe provokojnë ripërjetimin e dhimbjeve, duke rrezikuar deformimin e së vërtetës dhe fakteve", është thënë në tekstin e rezolutës.

Rezoluta po ashtu kërkon që organet e drejtësisë të hetojnë nëse ka vepra penale lidhur me paraqitjen e fakteve në këtë ekspozitë.

Ekspozita për "Masakrat në Kosovë 1998-1999" ishte larguar nga Komuna e Prishtinës ndërsa, Kuvendi i Kosovës, që kishte financuar një pjesë të ekspozitës të organizatave joqeveritare "INTEGRA" dhe "ADMOVERE", ka theksuar se organi ligjvënës mbështet iniciativë që trajtojnë çështje me interes publik, por kjo mbështetje jepet "pa ndërhyrë në përmbajtje të projekteve të tilla". Pas reagimeve të shumta,



Shkëlzen Gashi, në emër të organizatave "ADMOVERE" dhe "INTEGRA" se ekspozita është realizuar bazuar në librin e tij "Masakrat në Kosovë 1998-1999", të botuar në vitin 2024, ndërsa për përpilimin e listës së të vrarëve nëpër masakra, organizatat janë mbështetur në listën e të vrarëve nga "Libër Kujtimi i Kosovës" i Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë (HLC) organizatë e udhëhequr nga Natasha Kandiq, aktiviste serbe për të drejtat e njeriut. Megjithatë, Fondi për të Drejtën Humanitare ka reaguar duke thënë se dhënat e paraqitura të ekspozitë në disa raste japin pasqyrë të pasaktë që krimeve dhe kjo nuk ka të bëjë me çështje interpretimi, por "me mungesë elementare të njohurive mbi të

drejtën ndërkombëtare humanitare, faktet e vërtetuara në gjykatë dhe mënyrën e leximit të të dhënave". Kurse me urdhër të Prokurorisë Speciale, banesa e Gashit është bastisur më 30 mars dhe ai është marrë në pyetje nën dyshimet se ka kryer veprën penale "nxitja e përçarjes dhe mosdurimit".

**PDK-ja: Rezoluta, akt i rëndësishëm për mbrojtjen e së vërtetës historike dhe dinjitetit të viktimave të luftës**

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka mirëpritur miratimin në Kuvendin e Kosovës të rezolutës për mbrojtjen e së vërtetës historike dhe dinjitetit

të viktimave të luftës në Kosovë. Kjo rezolutë, e cila ka marrë mbështetjen e të gjitha grupeve parlamentare, dëshmoi se për çështjet që lidhen me sakrificën dhe historinë tonë kombëtare mund dhe duhet të ketë unitet të plotë institucional.

PDK-ja ka vlerësuar se ky është një moment i rëndësishëm reflektimi dhe përgjegjësie politike, ku Kuvendi i Kosovës u ngrit mbi dallimet partiake për të mbrojtur të vërtetën historike dhe për të nderuar me dinjitet viktimat e luftës dhe familjet e tyre.

Miratimi i kësaj rezolute është dëshmi se kur ka vullnet politik, institucionet tona mund të veprojnë të bashkuara në mbrojtje të vlerave themelore të shtetit tonë. Partia Demokratike e Kosovës ka theksuar se mbrojtja e së vërtetës për luftën çlirimtare dhe respekti për viktimat nuk janë çështje e debatit politik, por obligim i përhershëm institucional dhe moral. "PDK-ja do të vazhdojë të jetë e angazhuar që vendime të tilla të zbatohen në praktikë dhe që e vërteta historike të mbrohet nga çdo përpjekje për shtrembërim apo relativizim. PDK-ja falënderon të gjithë deputetët që sot votuan këtë rezolutë, duke dëshmuar përgjegjësi dhe respekt për të vërtetën historike dhe dinjitetin e viktimave të luftës", është thënë në reagimin e PDK-së.

## PROTESTA E STUDENTËVE NË PEJË: E TURPESHME TA MBROJTMË UÇK-në NGA SHQIPTARËT

PEJË, 10 PRILL - Sheshi i Pejës është mbushur të premtën me studentë dhe qytetarë të cilët kanë kundërshtuar fyerjen dhe gjuhën e urrejtjes ndaj ish-komandantit të zonës së Dukagjinit, Ramush Haradinaj, pas disa akuzave ndaj tij. Në këtë protestë, e cila është organizuar nga studentët e Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka", është thënë se nuk do të heshtin karshi shtrembërimit të historisë. Mes parullave "Unë studioj shqip falë UÇK-së", "Për UÇK-në, me UÇK-në" dhe "Larg duart nga UÇK-ja", studentët

kanë kërkuar të dëgjohet zëri i tyre.

Përfaqësuesi i studentëve, Ardit Bobi, e ka quajtur të turpshëm faktin që studentët janë duke e mbrojtur UÇK-në nga shqiptarët.

Bobi ka thënë se historia e Kosovës nuk mund shtrembërohet dhe dinjiteti i vendit nuk preket. "Është e turpshme të mendojmë se nga kush po e mbrojmë. Nuk po e mbrojmë nga serbët, por nga shqiptarët. Sot nuk jemi mbledhur këtu vetëm në një shesh qyteti. Sot jemi mbledhur



në një moment ku ndërgjegjja e një shoqërie vihet në provë sepse ka raste në histori kur një popull duhet të vendosë a duhet të heshtë përballë shtrembërimit, apo duhet të ngrihet në mbrojtje të së vërtetës. Ne sot kemi zgjedhur të mos heshtim sepse historia nuk është vetëm kujtim. Historia është themeli mbi të cilin qëndron një shtet dhe kur ai themel fillon të lëkundet nga pasaktësi e harresa, atëherë nuk rrezikohet vetëm e kaluara, por gjithë e ardhmja. Nuk jemi këtu për të krijuar zhurmë, por jemi

këtu sepse ndërgjegjja nuk na lejon të qëndrojmë të heshtur... Historia e Kosovës nuk shtrembërohet dhe e vërteta nuk relativizohet. Kujtesa nuk përdhohet. Dinjiteti i Kosovës nuk preket", ka thënë ai. Para studentëve dhe qytetarëve fjalën e ka marrë edhe rektori i Universitetit "Haxhi Zeka", Armand Krasniqi, i cili këtë protestë e ka quajtur jo të zakonshme dhe sinjal që ky universitet po formon individë që nuk janë indiferentë karshi zhvillimeve shoqërore. Sipas tij, institucionet e vendit e kanë për

obligim të krijojnë korniza ligjore që mbrojnë identitetin shoqëror. "Kjo nuk është një ngjarje e zakonshme. Është sinjal që duhet kuptuar, është dëshmi se universiteti po përmbush një nga funksionet e tij më thelbësore: të formojë individë që nuk janë indiferentë ndaj zhvillimeve shoqërore, por që reflektojnë dhe veprojnë me përgjegjësi. Ajo që po ndodh sot këtu nuk është një reagim i zakonshëm publik, po një moment që kërkon një qasje të balancuar dhe të matur, që kërkon lirinë e shprehjes, njëkohësisht e vendos atë liri përballë përgjegjësisë që ajo bart, një qasje që pranon debat, po nuk pranon deformim të vlerave themelore mbi të cilat qëndron shoqëria jonë. Në këtë kuptim roli i institucioneve legjislativë bëhet i domosdoshëm sepse ato kanë detyrimin për krijimin e një kornize që mbron dinjitetin shoqëror pa cenuar parimet demokratike", ka thënë Krasniqi.

Para disa ditësh një person është arrestuar në Pejë pasi kishte kërcënuar dhe ofenduar familjen Haradinaj.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, BURIM RAMADANI

# NA DUHET TË KEMI PRESIDENT, NUK NA DUHEN ZGJEDHJE

- Kosova është zhytur në amulli politike. Arritja e konsensusit për zgjedhjen e presidentit nuk duket se është afër

Njohësi i çështjeve politike dhe të sigurisë, Burim Ramadani, ka vlerësuar se Kosovës i duhet një president i ri dhe jo zgjedhje të reja parlamentare. Në këtë kontekst, Ramadani ka thënë se arritja e konsensusit për zgjedhjen e presidentit nuk duket se është afër. Në këtë intervistë për “Epokën e re”, ai ka thënë se përgjegjësia për zgjedhjen e presidentit u takon partive të mëdha në vend. Ramadani ka vlerësuar se Kosova është zhytur në amulli politike. Ai ka theksuar se mungesa e stabilitetit politik e institucional tash e gati dy vjet është duke cenuar funksionimin e shtetit. Krahas kësaj, Ramadani ka kritikuar edhe opozitën e cila, sipas tij, nuk është e strukturuar. Ndërsa sa i përket procesit gjyqësor në Hagë, Ramadani ka shprehur bindjen se liderët e UÇK-së do të shpallen të pafajshëm. “Jam i bindur se lirimi i të akuzuarve në Hagë do të paraqesë një moment kthese pozitive për Kosovën, historinë dhe të vërtetën tonë, sikurse edhe ta kthejë besimin publik për proceset”, ka thënë Ramadani

duhet një president i ri dhe jo zgjedhje të reja. Pavarësisht prej domosdoshmërisë që Kosova të ketë president të ri, Ramadani ka thënë se askush në skenën politike nuk i beson njëri-tjetrit. “Pothuajse secili e secila është pëshpjelluar në taktika elektorale e personale dhe ka kontribuar për ta thelluar mosbesimin e gjithanshëm. Rrjedhimisht, një situatë e tillë e dërgon Kosovën sërish në zgjedhje parlamentare dhe kjo është në kundërshtim me interesin kombëtar dhe vullnetin

qytetar. Arritja e konsensusit për zgjedhjen e presidentit nuk duket se është afër”, ka deklaruar Ramadani. Sa i përket përgjegjësisë për zgjedhjen e presidentit, Ramadani ka vlerësuar se një gjë e tillë u takon partive të mëdha parlamentare. “Pra, partitë më të mëdha kanë faj më shumë në këtë amulli të Kosovës. Ato që kanë fuqi përcaktuese janë fajtoret kryesore. Kështu, duke qenë në vazhdimësi e qeverisur nga njerëzit që janë ushtrues

detyre, Kosova është kthyer në një lloj ushtrues detyre shteti”, është shprehur Ramadani. Ramadani ka kritikuar edhe opozitën e cila, sipas tij, nuk është e strukturuar. “Në vend se të ndërtojnë qasje të përbashkët, partitë jopushtetare kanë vazhduar ta shohin vetëm veten në mënyrë të ndarë dhe nuk kanë dhënë opion tjetër qeverisës e institucional. Në periudhën e fundit kanë ndodhur disa takime të ndara midis LV-së dhe PDK-së e LDK-së për çështjen e presidentit. Uroj që këto takime të nxjerrin ‘tymin e bardhë’ më në fund, me qëllimin që Kosova të mos shkojë edhe njëherë në zgjedhje”, është deklaruar Ramadani. Më tutje, Ramadani ka komentuar edhe moskandidimin e Vjosa Osmanit për presidente nga ana e Lëvizjes Vetëvendosje. Ai ka thënë se moskandidimi i Osmanit për presidente nuk ka qenë befasi. “Të paktën jo për përcjellësit aktivë të zhvillimeve politike e institucionale. Z. Kurti, si fitues i zgjedhjeve të 28 dhjetorit 2025, ka të drejtën e plotë për të

kandiduar dikë për president. Normalisht që më e mira do të ishte që presidenti i ri të jetë konsensual dhe t’i përfaqësojë sa më gjerësisht partitë politike dhe qytetarët. Ajo që kemi parë është se z. Kurti ka vendosur në muajin mars ta përzgjedhë shërbyesin e ri në postin e presidentit, duke mos kandiduar shërbyesin e viteve të kaluara. Dhe, unë këtu i vendos pikë temës së këtyllë. Pra, z. Kurti ka ndërruar emrin e shërbyesit të tij në postin e presidentit, por nuk ka ndërruar konceptin apo qëllimin politik”, ka thënë Ramadani. Në rast se vendi shkon në zgjedhje të reja për shkak të mozhgjedhjes së presidentit, Ramadani ka thënë se është vështirë të pretendohet saktë ndikimi që Osmani mund të ketë në elektorat nëse ajo merr pjesë. “Unë do të doja që zonja Osmani të jetë pjesë e një fronti më të madh politik dhe jo e vetme apo jo vetëm me një parti. Në një rast krijimi të një fronti politik, atëherë kjo mund ta shumëfishojë mbështetjen elektorale”, ka theksuar Ramadani.

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 10 PRILL - Njohësi i çështjeve politike dhe të sigurisë, Burim Ramadani, ka vlerësuar se Kosova është zhytur në amulli politike. Ramadani në këtë intervistë për “Epokën e re” ka thënë se në skenën politike ka humbur të menduarit strategjik për qëllime të vogla të politikës ditore. Në këtë kontekst të zhvillimeve politike aktuale, Ramadani ka thënë se Kosovës i

Në këtë intervistë Ramadani ka folur edhe për procesin gjyqësor në Gjykatën Speciale në Hagë. Ai ka thënë se beson se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi do të shpallen të pafajshëm. “Besoj plotësisht se kjo do të ndodhë për udhëheqësit e luftës çlirimtare, sepse lufta çlirimtare ka qenë edhe e drejtë edhe e pastër. Nuk është vetëm çështje e imazhit të Kosovës nëpër botë, por është çështje direkte përmbajtësore e të vërtetës së Kosovës. Unë nuk kam parë që Prokuroria e Specializuar ka pasur rast të vërtetë në gjykatë. Kështu, as nuk është dashur të akuzohen. Jam i bindur se lirimi i të akuzuarve në Hagë do të paraqesë një moment kthese pozitive për Kosovën, historinë dhe të vërtetën tonë, sikurse edhe ta kthejë besimin publik për proceset”, ka thënë Ramadani.

**“Epoka e re”:** Z. Ramadani, si jeni duke i parë zhvillimet e përgjithshme në Kosovë duke iu referuar edhe ngjarjeve globale?

**Ramadani:** Kosova është zhytur në amulli politike. Krejtësisht e pavëmendshme për rrethanat globale të sigurisë dhe krejtësisht pa qartësi për pozicionin e saj. Faktikisht, këtu ka humbur të menduarit strategjik dhe e tëra është kthyer në taktika për qëllime të vogla të politikës ditore të brendshme. Mungesa e stabilitetit politik e institucional tash e gati dy vjet, mungesa e qasjes proaktive zhvillimore, mungesa e avancimit në modernizimin e sektorit të sigurisë dhe mungesa e një platforme të përbashkët politike për tema të interesit kombëtar realisht është duke cenuar funksionimin e shtetit. E tërë kjo, fatkeqësisht, po ndodh tashmë kur bota nuk është e sigurt. Pra, bota ka kaluar nga niveli i të qenit e trazuar në nivel të pasigurisë. Dhe, kjo nuk lidhet vetëm me aspektin e sigurisë ekonomike, por në mënyrë direkte me pasigurinë kombëtare të shteteve në kuadër të pasigurisë globale. Kështu, Kosova as nuk e ka të qartë se cilat janë interesat vitale shtetërore të saj dhe as nuk ka program për të ndërtuar qëndrueshmërinë dhe për të garantuar sigurinë kombëtare. Gjendja është kritike.

**“Epoka e re”:** A jeni duke parë vullnet politik për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit?

**Ramadani:** Na duhet të kemi president, nuk na duhen zgjedhje! Kjo do duhej të ishte fjalia udhëheqëse për partitë politike në këtë situatë. Sikur ky të ishte qëllimi, atëherë një manual veprimesh do të ndërtohej shumë lehtë dhe shumë thjesht. Deri më tash as kjo fjali nuk ekziston dhe as ky manual nuk është formësuar. Askush askujt nuk i beson sot në politikën kosovare. Pothuajse secili e secila është pështjelluar në taktika elektorale e personale dhe kanë kontribuar për të thelluar mosbesimin e gjithanshëm. Rrjedhimisht, një situatë e tillë e dërgon Kosovë sërish në zgjedhje parlamentare dhe kjo është në kundërshtim me interesin kombëtar dhe vullnetin qytetar. Arritja e konsensusit për zgjedhjen e presidentit nuk duket se është afër.

**“Epoka e re”:** Kush është fajtor për zvarritjen e procesit për zgjedhjen e presidentit?

**Ramadani:** Në secilën situatë, përgjegjësia matet me kapacitetin. Pra, partitë më të mëdha kanë faj më shumë në këtë amulli të Kosovës. Ato që kanë fuqi përcaktuese, pastaj, janë fajtoret kryesore. Kështu, duke qenë në vazhdimësi e qeverisur nga njerëzit që janë ushtrues detyre, Kosova është kthyer në njëllor ushtrues detyre shteti. Partitë së pari janë jodemokratike dhe ato marrin vendime në nivele individuale ose në rrethe tepër të ngushta. Rrjedhimisht, nuk përfaqësojnë as dëshirën e interesat e elektoratit të vet.

**“Epoka e re”:** Z. Ramadani, si jeni duke e parë sjelljen e opozitës për zgjedhjen e shefit të ri të shtetit?

**Ramadani:** Në Kosovë nuk ka opozitë të strukturuar. Ka parti që nuk janë në pushtet, por ato assesi nuk kanë arritur të gjejnë gjuhën e përbashkët dhe as qëllimet e përbashkëta. Që nga zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, partitë jopushtetare nuk kanë arritur të ndërtojnë koncept e platforme të përbashkët. Kështu, nuk i kanë dhënë qytetarëve një alternativë, nuk i kanë dhënë qytetarëve besimin se ato mund të



ndërrojnë pushtetin tashmë shumëvjeçar të LV-së. Në vend se të ndërtojnë qasje të përbashkët, partitë jopushtetare kanë vazhduar të shohin vetëm veten në mënyrë të ndarë dhe nuk kanë dhënë opsion tjetër qeverisës e institucional. Në periudhën e fundit, kanë ndodhur disa takime të ndara midis LV-së dhe PDK-së e LDK-së për çështjen e Presidentit. Uroj që këto takime të nxjerrin “tymen e bardhë” më në fund, me qëllimin që Kosova të mos shkojë edhe njëherë në zgjedhje. Pasi që këto parti jopushtetare kanë filluar diskutimet me LV-në për presidentin, besoj se do të ishte mirë që këto negociata të dalin në sukses. Në të kundërtën, besimi qytetar do të tronditej edhe më shumë dhe kjo do të çon tek një apati politike qytetare.

**“Epoka e re”:** Pse Kurti nuk e kandidoi Osmanin për presidente?

**Ramadani:** Mendoj që nuk ishte befasi. Të paktën jo për përcjellësit aktiv të zhvillimeve politike e institucionale. Z. Kurti, si fitues i zgjedhjeve të 28 dhjetorit 2025, ka të drejtën e plotë për të kandiduar dikë për president. Normalisht që më e mira do të ishte që Presidenti i ri të jetë konsensual dhe t’i përfaqësojë sa më gjerësisht partitë politike dhe qytetarët. Ajo që kemi parë është se z. Kurti ka vendosur në muajin mars të përzgjedh shërbyesin e ri në postin e presidentin, duke moskandiduar shërbyesin e viteve të kaluara. Dhe, unë këtu i vendos pikë temës së këtuillë. Pra, z. Kurti ka ndërruar emrin e shërbyesit të tij në postin e

apo grupore. Por, assesi për interes të Kosovës.

**“Epoka e re”:** Çfarë ndikimi mund të ketë Osmani në rezultatit zgjedhor në rast se do të mbahen zgjedhjet e reja?

**Ramadani:** Është vështirë të pretendohet saktë ndikimi që zonja Osmani mund të ketë në mbështetjen elektorale, nëse ajo merr pjesë. Këtu janë dy faktorë kryesorë që do të mund ta përcaktojnë ndikimin e saj. Së pari, sa është e cenushme ajo elektoralisht nëse përballlet me kundërshtarë real politik? Sepse, zonja Osmani nuk ka pasur asnjëherë ballafaqim politik në fushatë me kundërshtar. Ajo ka qenë e mbështetur nga shoqëria civile, mediet dhe LV-ja pothuajse vazhdimisht. Prandaj, mundësia që ajo të mos ketë të njëjtën situatë në fushatë do të mund të ndikojë në performancën elektorale. Së dyti, nëse do të merr pjesë në zgjedhje si parti në vete apo do të bëjë koalicion. Unë do të doja që zonja Osmani të jetë pjesë e një fronti më të madh politik dhe jo e vetme apo jo vetëm me një parti. Në një rast krijimi të një fronti politik atëherë kjo mund të shumëfishojë mbështetjen elektorale.

**“Epoka e re”:** Z. Ramadani, Kosova dhe shqiptarët janë në pritje të vendimit përfundimtar nga Gjykata Speciale për liderët e UÇK-së. Cili do të jetë epilogu dhe çfarë ndikimi mund të ketë vendimi i Speciales për proceset e ardhshme në Kosovë dhe jo vetëm?

**Ramadani:** Lutem për çdo ditë që verdikti në Hagë të jetë lirues. Besoj plotësisht se kjo do të ndodh për udhëheqësit e luftës çlirimtare, sepse lufta çlirimtare ka qenë edhe e drejtë, edhe e pastër. Nuk është vetëm çështje e imazhit të Kosovës nëpër botë, por është çështje direkte përmbajtësore e të vërtetës së Kosovës. Unë nuk kam parë që Prokuroria e Specializuar ka pasur rast të vërtetë në gjykatë. Kështu, as nuk është dashur të akuzohen. Jam i bindur se lirimi i të akuzuarve në Hagë do të paraqesë një moment kthese pozitive për Kosovën, historinë dhe të vërtetën tonë, sikurse edhe të kthejë besimin publik për proceset.

## HARADINAJ: JO NDOSHTA, POR JEMI NË ZGJEDHJE

PRISHTINË, 10 PRILL - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë folur për medie sa i përket çështjes së zgjedhjes së presidentit të ri. Kur është pyetur se mos ndoshta kryeministri Albin Kurti po dëshiron të shkojë në zgjedhje të reja, Haradinaj ka thënë: “Jo ndoshta, por jemi në zgjedhje”. Sipas tij, sikur Kurti të dëshironte ta zgjedhte presidentin e di si shkojnë këto procese pasi, siç ka theksuar Haradinaj, ka përvojë politike në zgjedhjen e shefit të shtetit.

“Nuk e ka me rëndësi se e ka veten... Jo ndoshta, po jemi në zgjedhje. Sikur të kishte dashur ta zgjedhë presidentin, ai e di si shkojnë këto punë dhe këto procese. Ne kemi përvoja politike dhe disa herë kemi arritur ta zgjedhim presidentin. Pra, ai nuk e ka hapur paketën fare të qeverisë, me thënë qeverinë po e ndali për vete e kur vjen puna e presidentit, urdhëroni të merremi vesh. Kjo shkon ndryshe, me atë që e fton për partneritet për president, pra bëhesh partner edhe në



qeveri”, ka thënë ai. Haradinaj ka folur për kalimin e deputetes Duda Balje në grupin parlamentar të AAK-së, duke thënë se nuk kanë dallime në qëndrime sa i përket Kosovës. “Tani mendoj se është mirë edhe për deputeten Duda Balje. Nuk kemi shumë dallime në qëndrime sa i përket Kosovës, sa iu përket vlerave të demokracisë, zhvillimit ekonomik, por edhe përkrahjes së komuniteteve. Aleanca gjithmonë ka qenë e kujdesshme”, ka thënë Haradinaj.


## Shembja e rrugës në Prishtinë, komuna shqipton gjobë ndaj investitorit

PRISHTINË, 10 PRILL - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se janë shqiptuar gjoba ndaj investitorit dhe përfaqësuesit ligjor lidhur me rastin e shembjes së rrugës "Don Shtjefën Kurti" në kryeqytet. Sipas tij, investitori nuk ka

respektuar vendimin për mbushjen e gropës në "Llamelat 4 dhe 5" dhe për këtë janë shqiptuar masat ndëshkuese nga autoritetet komunale. Rama ka njoftuar se ndaj kompanisë është vendosur një gjobë prej 30 mijë eurosh, ndërsa për

përfaqësuesin ligjor është shqiptuar gjobë në vlerë prej 3 mijë eurosh. Ai i ka bërë thirrje Odës së Inxhinierëve të Kosovës që të ndërmarrë veprime ndaj inxhinierëve mbikëqyrës, duke kërkuar tërheqjen e licencave të tyre për shkak të mungesës së transparencës në

vendimmarrje. "Deri më sot nuk janë prezantuar vendimet e inxhinierëve mbikëqyrës, prandaj kërkojmë nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës iniciimin e procedurave për tërheqjen e licencave të inxhinierëve mbikëqyrës!", ka njoftuar Rama.



# MBYLLEN DY ORDINANCA NË VENDBANIMET ME SERBË NË SKENDERAJ

SKENDERAJ, 10 PRILL - Kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, ka njoftuar se pas pranimit të informatave dhe verifikimit të tyre, ka lëshuar urdhëresë për mbylljen e dy Ambulancave të Mjekësisë Familjare (AMF) në dy vendbanimet me komunitetin joshumicë serb në Banjë dhe në Syriganë, të cilat kishin filluar të funksiononin ilegalisht nën menaxhimin e strukturave paralele serbe, jashtë rendit kushtetues e ligjor të Republikës së Kosovës. "Ajo që kemi gjetur është e papranueshme: medikamente pa banderola dhe me afat të skaduar, përdorim i vulave dhe receta mjekësore pa prezencën e mjekut dhe shumë shkelje të tjera që bien në kundërshtim me ligjet dhe protokollet shëndetësore. Kjo përveçse shkelje ligjore përbën rrezikim të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e

qytetarëve. Nuk do të lejojmë që askush të rrezikojë jetën dhe shëndetin e qytetarëve duke vepruar jashtë sistemit dhe ligjeve të Republikës së Kosovës. Kemi ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe kemi njoftuar edhe autoritetet përkatëse përfshirë edhe Agjencinë e Kosovës për produkte dhe pajisje medicinale", ka shkruar Lushtaku në "Facebook". Ai ka thënë se këto ordinanca do të funksionalizohen kur të integrohen në sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës. "Këto dy AMF mund të rikthehen në funksion vetëm kur të integrohen plotësisht në sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës dhe të zbatohen pa asnjë kompromis kushtetutë dhe ligjet e Kosovës sepse vetëm në këtë formë mbrohet jeta dhe shëndeti i qytetarëve pa dallim!", ka shkruar Lushtaku.



# MUNGOJNË FITORE PACOLLI, DRITA MILLAKU DHE SALIH ZYBA, DËSHTON SEANCA PËR GAZIN LOTSJELLËS



PRISHTINË, 10 PRILL - Një seancë gjyqësore për rastin e hedhjes së gazit lotsjellës ka dështuar të premten në Prishtinë për shkak të mungesës së të akuzuarve, përfshirë ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Fitore Pacolli-Dalipi, dhe deputetin Salih Zyba.

Seanca nuk është mbajtur pasi të akuzuarit Pacolli-Dalipi, Drita Millaku dhe Zyba nuk ishin të pranishëm në gjykatë.

Gjyqtari i çështjes, Sabit Sadikaj, ka thënë se Zyba kishte njoftuar gjykatën për pamundësinë e pjesëmarrjes për shkak të një seance plenare në Kuvendin e Kosovës, ndërsa Pacolli-Dalipi kishte arsyetuar mungesën e saj. Për të akuzuarën Millaku, gjykata nuk ka pasur konfirmim nëse ajo e ka pranuar ftesën për seancën, pasi kjo nuk rezulton nga fletëkthesa, ka thënë Sadikaj. Gjykata do të lëshojë urdhër

për sjellje me detyrim për të akuzuarit, ndërsa mbrojtësit e tyre do të ftohen në mënyrë të rregullt. Në seancë ishte i pranishëm prokurori i shtetit, Avni Namani.

Në këtë rast, për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës në mars të vitit 2018, bashkë me Zybën akuzohen ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ministrja Fitore Pacolli-Dalipi dhe ish-deputetja Drita Millaku.

## Hapet rruga për ndërtimin e Qendrës Emergjente në QKUK

PRISHTINË, 10 PRILL - Tanimë është hapur rruga për ndërtimin e Qendrës Emergjente në Qendrën Klinike

dhe Universitare të Kosovës (QKUK). Lajmin e ka bërë me dije ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia. "Pas shumë sfidave,

i është dhënë dritë e gjelbër Ministrisë për vazhdimin e punimeve. Sot kam nënshkruar kontratën, sipas së

cilës Qendra Emergjente pritet të përfundojë brenda 30 muajsh", ka shkruar Vitia në "Facebook".



## KURTI NË LONDËR TAKOHET ME MINISTRIN E SHTETIT PËR MBROJTJE, FLASIN PËR BASHKËPUNIMIN USHTARAK

LONDËR, 10 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në kuadër të vizitës zyrtare në Mbretërinë e Bashkuar, është pritur në takim nga ministri i Shtetit për Mbrojtje, Lord Vernon Coaker, në "Naval and Military Club", në Londër. Gjatë darkës, siç ka njoftuar zyra e kryeministrit, Kurti ka falënderuar Lordin Coaker për mbështetjen historike të Mbretërisë së Bashkuar ndaj Kosovës, duke përmendur në veçanti ndihmën ndaj refugjatëve, rolin

e gjeneralit Michael Jackson në çlirim, si dhe pas luftës në shtet-ndërtim, zhvillim dhe integrim. "Kryeministri Kurti theksoi se Kosova dëshiron të ketë bashkëpunim edhe më të ngushtë ushtarak dhe të mbrojtjes, në drejtim të vlerave dhe qëllimeve të përbashkëta. Në këtë kontekst, ai përmendi bashkëpunimin në fusha specifike, si bashkëzëbarkimet, trajnimet dhe zhvillimin e kapaciteteve", ka njoftuar zyra e kryeministrit.



## CERTIFIKOHEN 36 REKRUTË TË FSK-së NGA RADHËT E KOMUNITETEVE JOSHUMICË



FERIZAJ, 10 PRILL - Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) ka njoftuar se në një ceremoni solemne të organizuar të premten në ambientet e kazermës "Skënderbeu" në Ferizaj janë certifikuar 36 rekrutë nga radhët e komuniteteve joshumicë të cilët i janë bashkuar FSK-së si ushtarë të saj. Në këtë ceremoni, siç është thënë, janë certifikuar rekrutë nga komunitetet turk, ashkali, boshnjak, rom dhe egjiptas, duke dëshmuar përkushtimin e vazhdueshëm të FSK-së për ndërtimin e një force gjithëpërfshirëse, profesionale dhe shumetnike. "Gjatë trajnimit të tyre, rekrutët kanë përfutur njohuri dhe aftësi themelore ushtarake, duke u përgatitur për

të kontribuar në realizimin e misionit të FSK-së në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës", ka njoftuar FSK-ja. Në ceremoni, përveç udhëheqësve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, të pranishëm ishin edhe familjarë të rekrutëve, si dhe mysafirë të ftuar, të cilët ndanë këtë moment të rëndësishëm me të diplomuarit. "Certifikimi i këtyre rekrutëve përfaqëson një hap të rëndësishëm në rrugëtimin e tyre profesional dhe njëkohësisht kontribuon në forcimin e kapaciteteve të FSK-së si një institucion modern, gjithëpërfshirës dhe në shërbim të vendit", ka njoftuar FSK-ja.

## KUVENDI RATIFIKON KATËR MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

PRISHTINË, 10 PRILL - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë ratifikuar katër marrëveshje ndërkombëtare në vlerë prej miliona eurosh. Mbi 80 vota ka marrë marrëveshja e kredisë mes Kosovës dhe Asociacionit Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Zhvillimit të Sektorit Financiar të Kosovës. Po ashtu, është ratifikuar edhe marrëveshja e kredisë mes Kosovës dhe

Agjencisë Franceze për Zhvillim për Programin e Kredisë të Bazuar në Politika. Sipas ministrit të Financave, Hekuran Murati, kjo marrëveshje është në vlerë prej 80 milionë eurosh. Dritën jeshile e ka marrë edhe marrëveshja e kredisë mes Kosovës dhe qeverisë gjermane për kredi në sektorin e energjisë dhe klimës. Ministri Murati ka thënë se kjo marrëveshje, po ashtu në vlerë prej 80 milionë

eurosh, mbështet politikat dhe reformat në sektorin e energjisë. Po ashtu, është ratifikuar edhe marrëveshja e kredisë me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin "Lehtësimi i Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0. Murati ka thënë se marrëveshja është në kuadër të një projekti rajonal dhe është 35 milionë euro kredi dhe 12 milionë në formë të grantit.



### Arlinda Muqa zgjedhet anëtare joprokurore e KPK-së

PRISHTINË, 10 PRILL - Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur Arlinda Muqën anëtare joprokurore të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK). Muqa ka marrë 59 vota të

deputetëve të Kuvendit. Me zgjedhjen e Muqës është kompletuar edhe përbërja e re e Këshillit Prokurorial. Muqa është zgjedhur anëtare nga

radhët joprokurore nga shoqëria civile. Në garë ishte edhe Novitet Mezaj, i cili ka marrë 24 vota të deputetëve dhe Artan Fejzullahu, për të cilin kanë

votuar vetëm tre deputetë. Muqa ka qenë monitoruese e sistemit të drejtësisë në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD).

## Paga e 13, Murati: Nuk po shpikim asgjë, është praktikë e zakonshme në vendet e BE-së

PRISHTINË, 11 PRILL - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka deklaruar se praktika e pagës së 13 ekziston në vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe nuk është një ide e re. Këtë deklaratë Murati e ka dhënë duke iu përgjigjur kritikave të deputetëve të AAK-së lidhur me mospërkrahjen e sektorit privat. Ai ka thënë se paga e 13 është obliguese në disa shtete si Italia, Spanja dhe Portugalia, ndërsa në vende të tjera si Austria, Gjermania, Holanda dhe Franca, edhe pse nuk është detyrim ligjor, ajo jepet në mënyrë të zakonshme çdo vit, madje në disa raste edhe paga e 14. Më tutje ai ka përmendur masat



financiare të ndërmarrë nga qeveria për mbështetjen e familjeve dhe sektorit privat, duke theksuar se gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar janë

ndarë 70 milionë euro si pagesë e njëhershme për familjet dhe pensionistët. "Për sa i përket asaj se çfarë po bëhet për sektorin privat apo çfarë qeveria ka bërë,

më lejoni t'ju kujtoj se 70 milionë euro në dhjetor të vitit të kaluar janë dhënë si pagesë e njëhershme, për të gjitha familjet që kanë fëmijë apo pensionistë. Pra të gjitha familjet kanë qenë përfituese. Pensionistët kanë marrë një shtesë prej 100 eurove në fund të vitit, gjithashtu secili fëmijë dhe secila familje që ka pasur fëmijë, për çdo fëmijë ka marrë nga 100 euro shtesë. Për më tepër, pra përveç pagesës së njëhershme, më lejoni gjithashtu t'ju kujtoj që me qeverisjen tonë, për sektorin privat dhe për të gjitha familjet, pra për nënat dhe fëmijët, tashmë jo një herë në vit, por çdo vit jepen 200 milionë euro për shtesat për fëmijë dhe

për shtesat për nënat lehona", ka thënë Murati në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa deputeti i AAK-së, Besnik Tahiri, gjatë seancës plenare e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për mospërkrahje të punëtorëve të sektorit privat pas shpërndarjes së pagës së 13 për sektorin publik. Ai ka thënë se punëtorët e sektorit privat janë kontribuuesit kryesorë në buxhetin e shtetit dhe se, sipas tij, ky sektor po neglizhohet nga qeveria. Tahiri ka theksuar se pikërisht ky sektor paguan taksat që mundësojnë funksionimin e sektorit publik, duke kërkuar trajtim më të barabartë për punëtorët e ekonomisë private.

## RRITJA E ÇMIMEVE VAZHDOI EDHE GJATË MARSIT

Prishtinë, 10 prill - Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit ka shënuar rritje gjatë muajit mars 2026, duke konfirmuar vazhdimin e trendit të shtrenjtimit të jetesës në vend. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), inflacioni mujor në mars ka arritur në 1.5 për qind krahasuar me muajin shkurt. Rritja është ndikuar kryesisht nga shtrenjtimi i karburanteve dhe lubrifikantëve për pajisjet e transportit personal, që kanë shënuar rritje prej 25.8-përqindësh. Po ashtu, çmimet janë rritur edhe te perimet me 3.7 për qind, pemët me 1.5 për qind dhe mishin me

0.3 për qind, duke kontribuar së bashku me rreth 1.7 për qind në rritjen e indeksit.

Në anën tjetër, një ulje e lehtë është evidentuar tek energjia elektrike me 3.7 për qind dhe te lëndët djegëse të ngurta me 2.2 për qind, duke ndikuar në ulje të indeksit me rreth 0.2 për qind.

Sa i përket krahasimit vjetor, inflacioni në mars 2026 ka arritur në 6.7 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Rritjet më të theksuara janë regjistruar te shërbimet që lidhen me transportin personal me 42.5 për qind, biletat e fluturimeve me 38.4 për qind, si



dhe furnizimi me ujë dhe shërbimet e banimit me 31.9 për qind. Rritje të konsiderueshme janë evidentuar edhe te energjia

elektrike dhe karburantet me nga 17.4 për qind, lëndët djegëse me 15.6 për qind dhe pushimet e organizuara me

13.2 për qind.

Ndërkohë, produktet ushqimore kanë vazhduar të kenë ndikim në rritjen e përgjithshme të çmimeve, përfshirë pemët me 13.1 për qind, mishin me 12.4 për qind, si dhe kafënë, çajin dhe kakaon me 7.8 për qind. Rritje janë shënuar edhe në shërbimet hoteliere, kujdesin personal, shërbimet shëndetësore dhe mallrat për mirëmbajtjen e ekonomisë familjare. Të dhënat tregojnë se presionet inflacioniste mbeten të pranishme në sektorë të ndryshëm, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kostos së jetesës për qytetarët.

## OEAK-u KËRKON REFORMA URGJENTE, PARALAJMËRON RREZIQE NGA PASIGURIA POLITIKE DHE MUNGESA E VENDIMEVE FISKALE

Prishtinë, 10 prill - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka shprehur shqetësim për brishtësinë institucionale dhe mungesën e konsensusit politik në vend, duke paralajmëruar pasoja në zhvillimin ekonomik dhe reformat strukturore. Në një deklaratë publike, OEAK-u ka theksuar se pas një periudhe të zgjatuar të bllokadave institucionale, ekziston rreziku që edhe viti 2026 të karakterizohet me përparim të kufizuar në reformat ekonomike. "Pas pothuajse një viti të plotë të reformave të

ndalura në vitin 2025, ekziston rreziku real që edhe viti 2026 mund të jetë një vit i përparimit të kufizuar në aspektin e reformave", është thënë në deklaratën e OEAK-ut. Sipas OEAK-ut, pasiguria politike dhe qeverisja e dobët ekonomike po ndikojnë drejtpërdrejt në besimin e investitorëve dhe në procesin e transformimit strukturor të ekonomisë.

"Qeverisja e dobët ekonomike, e kombinuar me pasigurinë politike, minon momentumin e reformave, vonon transformimin strukturor dhe dobëson besimin e



investitorëve", ka theksuar OEAK-u.

Në këtë deklaratë, OEAK-u ka shprehur shqetësim edhe për mungesën e rishikimit të politikave fiskale për karburantet, në kushtet e luhatjeve globale të çmimeve të energjisë.

Oda Amerikane ka vlerësuar se

disa shtete kanë ndërmarrë masa lehtësuese për ta zbutur ndikimin e krizave ndërkombëtare, ndërsa Kosova, sipas saj, rrezikon rritje të barrës mbi bizneset dhe konsumatorët. Në këtë kontekst, OEAK-u u është referuar edhe gjetjeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili, sipas deklaratës, ka theksuar ngadalësim të rritjes ekonomike dhe ndikim të pasigurisë politike në treguesit makroekonomikë të vendit. "Raporti i fundit i Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovën thekson se pasiguria politike tashmë ka ngadalësuar

rritjen, ka rritur inflacionin dhe ka dobësuar pozicionin e jashtëm të Kosovës", është thënë në deklaratë.

Oda Amerikane ka theksuar se stabiliteti institucional dhe parashikueshmëria e politikave mbeten elemente kyçe për përballimin e sfidave aktuale ekonomike.

Në fund të kësaj deklaratë publike OEAK-u ka bërë thirrje për forcim të dialogut publiko-privat, duke e konsideruar të domosdoshëm për hartim më efikas të politikave dhe për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në vend.

## Rezoluta për çmimet e naftës nuk miratohet, deputetët e LV-së votojnë kundër

Prishtinë, 10 prill - Propozimi i grupit parlamentar të LDK-së për rezolutën për rritjen e çmimeve të naftës nuk ka

kaluar në Kuvendin e Kosovës. 34 vota ishin për, 49 kundër dhe 7 abstenime. Rrjedhimisht kjo rezolutë nuk është mbështetur nga

deputetëve e Lëvizjes Vetëvendosje. Kjo çështje ishte zhvendosur të trajtohet si pikë e gjashtë pasi fillimisht kishte mospajtime mes

partive politike. Rezoluta për çmimin e naftës ishte propozuar javën e kaluar pas debatit parlamentar për këtë çështje.



POEZI PËR HEROIN E KOMBIT BESIM NDRECAJ

# PUSHKA PËR ATDHEUN

## BESIM NDRECA KURRË S'HARROHET




Gjovalin DUSHAJ, Poet nga Shqipëria  
(Pukë-Lezhë)

Sa shumë vuajtje dhe rënkime  
I ka vujtë Kosova ime  
Sa shumë lot nanat shqiptare  
I kanë derdhë mbi ato varre.

I kanë mblu shumë djem të ri  
T'mjerat nanat veshun n'zi  
Shumë prej tynë nuk janë gjetë  
N'cilin dhe djemt ju kanë mbetë.

Por shqiptarët s'dinë me vajtue  
Dinë heronjt veç n'kangë me i kndue  
N'çifteli e n'tel t'lahutës  
Besim Ndreca hero t'luftës.



Në moshë t're tu kry ushtrinë  
Nuk pyet djali për Serbinë  
Me thikë n'dorë një oficer  
E rrëzoi n'tokë dhe e ka therë  
Dy vjet n'burg i mbajti Trimi  
Nuk dorëzohet kurrë Besimi.

Ish anëtar n'Njësit Gueril  
N'ballë i duel çdo shkau katil  
N'prita t'vona të çdo nate  
S'ju tremb syni n'atentate.

Në Lubizhdë përmendet trimi  
Nuk dorëzohet Luan Besimi  
Po ja qet flakën alltisë  
Komandantin e policisë.

Vrau Shoshkiçin ballë për ballë  
Se përgjaku ai shumë shqiptarë  
Si Besimin s'ban ma nana  
S'don me ndi për kapetana.


N'Malsi t'Re policët kanë ardhë  
Nuk dorëzohem jam shqiptar  
Nalt mbi fshat n'helikopter  
E vrau Besimin një snajper.

Përballë shkaut me armë në dorë  
Derdhi gjakun ra dëshmor  
Ruhet pushka sot n'muze  
Që e shprazi për Atdhe.

Kanë lindë nanat shumë heronj  
Kanë lindë zanat djem dragoj  
Si rrufeja përmbi shkrep  
Shqipe mali Besim Ndreca.

Në Korishë afër bajrakut  
I kanë ra pikat e gjakut  
Skuqi shkam e skuqi gur  
I betuar në flamur.

Besim Ndreca kurrë s'harrohet  
N'oda burrash kanga i knodhet  
Ky luan i Dardanisë  
Ra dëshmor i Shqipërisë.



# A DO TË SIGUROJË TRUMP NJË MARRËVESHJE MË TË MIRË SE OBAMA ME IRANIN?

WASHINGTON (CNN) – Ajo që vetëm një javë më parë u cilësua nga Presidenti Trump si një propozim "i realizueshëm" për t'i dhënë fund dekadave të armiqësisë me Iranin, sot po shpërbëhet nën peshën e kërkesave maksimaliste dhe realiteteve të reja gjeopolitike. Ndërsa bota priste një nënshkrim historik, analiza e sotme tregon se hendeku midis Uashingtonit dhe Teheranit nuk ka qenë kurrë më i madh, duke e lënë rajonin në buzë të një humnere ekonomike dhe ushtarake.

## Hormuzi si levë e re presioni

Ndryshe nga viti 2015, kur administrata Obama u fokusua pothuajse ekskluzivisht te pasurimi i uranimit, kriza e vitit 2026 ka një epiqendër të re: Ngushticën e Hormuzit. Irani nuk kërkon më thjesht heqje sanksionesh; ai po kërkon rishkrimin e rregullave të lundrimit global. Propozimi i tyre për të vendosur taksa mbi naftën që kalon nëpër këtë pikë strategjike ka goditur si rufe

tregjet globale, duke e detyruar administratën Trump të zgjedhë midis një marrëveshjeje që do të ulte çmimet e karburantit në shtëpi, ose pranimit të një poshtërimit strategjik ku Irani kontrollon rubinetin e energjisë botërore.

## Hije mbi trashëgiminë e Obamës

Analistët e CNN vërejnë se krahasimi me marrëveshjen JCPOA të vitit 2015 është i pashmangshëm, por i dëshpëruar. Aty ku Obama ndërtoi një strukturë inspektimi fizik dhe diplomaci të ngadaltë shumëpalëshe, Trump po tenton një "goditje të shpejtë" diplomatike. Strategjia e re amerikane zëvendëson inspektorët e OKB-së me monitorim satelitor të fuqizuar nga Inteligjenca Artificiale dhe kërcënimin e goditjeve të menjëhershme ajrore. Kritikët thonë se ky është një bixhoz i rrezikshëm: nëse teknologjia dështon ose nëse Irani fsheh lëvizjet e tij, bota mund të zgjohet me një Iran bërthamor brenda natës, pa asnjë roje në terren për



ta ndaluar.

Sipas burimeve brenda Shtëpisë së Bardhë, vetë administrata është e ndarë. Nga njëra anë, pragmatistët si Kushner dhe Witkoff po shohin mundësinë për një stabilitet ekonomik që do të ndihmonte fushatën zgjedhore. Nga ana tjetër, "skifterët" si Sekretari i Shtetit Marco Rubio po bllokojnë çdo

lëshim që do t'i jepte Iranit legjitimitet mbi ujërat ndërkombëtare. Kjo përçarje po e bën pozicionin amerikan të duket i paqëndrueshëm (wobbly) në sytë e aleatëve dhe armiqve. Me mbi 900 paund uranium të pasuruar që qëndrojnë ende në depot iraniane dhe çmimet e naftës që po fluturojnë, analiza e CNN konkludon se koha për një

"marrëveshje të artë" mund të ketë kaluar. Irani ka mësuar se kontrolli i Hormuzit është më i vlefshëm se çdo premtim diplomatik, ndërsa Uashingtoni po zbulon se as presioni maksimal dhe as diplomacia e shpejtë nuk po arrijnë të zhbëjnë realitetin e ri të një Lindjeje të Mesme që po del nga kontrolli i SHBA-së.

# SKANDALI EPSTEIN - CNN BRENDA PLANIT TË MELANIA TRUMP PËR TË MBYLLUR THASHETHEMET E VJETRA

WASHINGTON (CNN) — Në një skenë të pazakontë që tronditi kryeqytetin të enjten pasdite, Zonja e Parë Melania Trump u shfaq në Grand Foyer të Shtëpisë së Bardhë për të adresuar drejtpërdrejt atë që ajo e quajti "një fushatë dashakeqe shpifjesh". Deklarata e saj, e cila zgjati rreth 15 minuta, vjen si pasojë e publikimeve të fundit masive të dokumenteve nga Akti i Transparencës për Dosjet Epstein, të cilat kanë risjellë në dritë emrat e elitës botërore të lidhur me financierin e turpëruar.

E veshur me një kostum të errët dhe me një ton të prerë, Melania Trump zgjodhi të mos përdorte zëdhënësit, por të fliste vetë për të fshirë çdo hije dyshimi mbi integritetin e saj. "Unë kurrë nuk kam qenë mikeshë me Jeffrey Epstein," deklaroi ajo, duke iu referuar një emaili të vitit 2002 drejtuar Ghislaine Maxwell, i cili u bë viral javën e kaluar. Ajo e cilësoi mesazhin si një "shkëmbim banal kortezie" që nuk reflektonte asnjë lidhje të ngushtë apo dijeni mbi aktivitetet kriminale të Epstein. Pika më e nxehtë e fjalimit ishte rishkrimi i historisë së takimit të saj me Donald Trump. Për vite

me radhë, spekulimet kanë sugjeruar se Epstein ishte njeriu që i prezantoi ata në vitin 1998. Zonja e Parë i hodhi poshtë këto pretendime si "fantazi mediatike", duke pohuar se ajo e takoi bashkëshortin e saj rastësisht dhe se rrugët e saj me Epstein nuk u kryqëzuan deri në vitin 2000, kur ai ishte tashmë pjesë e rrethit të gjerë shoqëror të Nju Jorkut.

Analistët e CNN vërejnë se kjo dalje ishte sa një mbrojtje ligjore, aq edhe një lëvizje politike e llogaritur mirë. Duke kërkuar që Kongresi të hapë dëshmi publike për viktimat e Epstein, Melania Trump bëri një manovër "shahmat". Ajo e zhvendosi veten nga pozicioni i personit nën mbrojtje, në atë të avokates për drejtësi.

Kjo lëvizje duket se ka krijuar një fërkim brenda vetë Shtëpisë së Bardhë. Ndërsa stafi i saj konfirmoi se ajo ishte e vendosur për të folur, Presidenti Trump u shfaq i kapur në befasi, duke u thënë gazetarëve në Zyrën Ovale se "ajo e ndjeu se duhej ta bënte", por duke lënë të kuptohet se nuk kishte pasur një koordinim të plotë mes dy kraheve të ndërtesës.


Zonja e Parë nuk kurseu as paralajmërimet ligjore. Ajo



përmendi me emra mediat që ishin detyruar të tërhiqnin lajmet e tyre pas padive të saj, duke e cilësuar këtë si një betejë për të vërtetën në një kohë të mbushur me "deepfakes" dhe dokumente të keqinterpretuara.

Për Melania Trump, ky fjalim nuk ishte vetëm për të kaluarën, por për të ardhmen. Në vitin 2026, kur transparenca është kthyer në një kërkesë agresive të publikut, ajo zgjodhi të ekspozohet për të kontrolluar

narrativën e saj, përpara se dosjet e tjera të mundshme të hidhnin më shumë benzinë zjarrit. Mesazhi ishte i qartë: ajo nuk do të jetë më një spektatore e heshtur e historisë së saj, por autorja e saj.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Sot dhe nesër luhen ndeshjet e javës së 28 në Superligë

**PRISHTINË, 10 PRILL** - Federata e Futbollit e Kosovës ka publikuar orarin e ndeshjeve të javës së 28 të

Superligës. Sot (e shtunë) në orën 15:00 zhvillohet ndeshja në mes të Prishtinës së Re dhe

Malishevës, ndërsa nesër (e diel) luhen katër ndeshjet e tjera: Ballkani - Gjilani, Drita - Ferizaj, Llapi -

Drenica dhe Prishtina - Dukagjini. Të gjitha këto ndeshje do të fillojnë në orën 15:00.

XHIRO 28	
PRISHTINA E RE	MALISHEVË
15:00	15:00
BALLKANI	GJILANI
15:00	15:00
DRITA	FERIZAJ
15:00	15:00
LLAPI	DRENICA
15:00	15:00
PRISHTINA	DUKAGJINI
15:00	15:00

## KOSOVA I NIS ME FITORE BINDËSE PARAKUALIFIKIMET PËR BOTËRORIN 2028 NË FUTSALL

**IGALO, 10 PRILL** - Kombëtarja e Kosovës në futsal e ka nisur me fitore të thellë fushatën e parakualifikimeve për Botërorin 2028 që po mbahen në Mal të Zi. "Dardanët" kanë triumfuar ndaj Gjibraltarit me rezultat 11:0 në ndeshjen e zhvilluar në Igallo.

Ekipi i drejtuar nga përzgjedhësi Agon Ramadani ka dominuar plotësisht në takim, duke kontrolluar lojën nga fillimi deri në fund dhe duke mos i lënë hapësirë kundërshtarit. Figura kryesore e



ndeshjes ishte Drilon Maxharraj, i cili ka realizuar hat-trick, ndërsa me paraqitje

të mirë është dalluar edhe Shefki Kameri me dy gola. Në listën e realizatorëve janë

regjistruar edhe Ylli Mazreku, Ramadan Alaj, Dilon Haxhijaj dhe Shqiprim Imeri, ndërsa një gol ka ardhur si autogol i Alan Parker.

Kosova bën pjesë në Grupin D të parakualifikimeve së bashku me Austrinë dhe Malin e Zi. Dy ekipet e para nga grupi sigurojnë kualifikimin në raundin kryesor, ndërsa shorti për këtë fazë do të tërhiqet më 19 qershor. Për këtë fitore bindëse, presidenti i FFK-s, Agim Ademi, ka uruar lojtarët "dardanë". "Përgëzoj djemtë e

Kombëtares së Kosovës në futsal dhe stafin teknik për fitoren thellë dhe paraqitjen mbresëlënëse në ndeshjen hapëse të parakualifikimeve për Botërorin 2028 kundër Gjibraltarit (11:0). Ky fillim i fuqishëm dëshmon përkushtimin, cilësinë dhe ambicien e Dardanëve tanë për të arritur objektivat e këtij cikli kualifikues. Suksese në ndeshjet e radhës kundër Austrisë dhe Malit të Zi. Uroj të vazhdoni me të njëjtin ritëm! Forca Kosovë!", ka shkruar Ademi në "Facebook".

## ISH-BASKETBOLLISTI BËHET KRYETAR I RI I KLUBIT TË FUTBOLLIT FERONIKELI

**DRENAS, 10 PRILL** - Klubi i Feronikelit '74 ka mbajtur Kuvendin e Jashtëzakonshëm, në të cilin ka zgjedhur kryesinë e re. Në këtë kuvend të gjithë anëtarët unanimisht kanë zgjedhur Alban Veselin në pozitën e presidentit të klubit, Lapidar Lladrovci, drejtor sportiv si dhe Argjend Bardhin, menaxher të klubit. Me këtë rast presidenti i ri i klubit, Alban Veseli, ka shprehur mirënjohjen dhe falënderimin

e tij për besimin e dhënë nga anëtarët e Kuvendit dhe Bordi Drejtues. "Jam i privilegjuar të menaxhoj një klub siç është FC Feronikeli '74. Po ashtu, jam i nderuar që në klub gjeta bashkëpunëtorë me energji të jashtëzakonshme për angazhim dhe punë. Së bashku do të punojmë fuqishëm që FC Feronikeli '74 në vitet e ardhshme të jetë ndër klubet më të organizuara dhe kështu ta bëjmë krenar

qytetin e Drenasit, e pse jo edhe gjithë Kosovën. Fokusi ynë primar do të jetë gjithashtu zhvillimi i akademisë, duke krijuar kushte sa më të mira për talentët e rinj që do të vijnë", ka thënë Veseli. FC Feronikeli '74 i uron suksese presidentit Veseli në këtë detyrë të rëndësishme dhe shpreh besimin se nën udhëheqjen e tij klubi do të arrijë suksese të reja.



## MURIQI NUK DO TË PENSIONOHET NGA KOMBËTARJA E KOSOVËS



**MALLORCA, 11 PRILL** - Sulmuesi Vedat Muriqi e kishte pasur të qartë se do të pensionohej nga Kombëtarja e Kosovës pas pjesëmarrjes në Kupën e Botës. Megjithatë, kualifikimi historik në Kupën e Botës nuk ka ndodhur, pasi "Dardanët" janë mposhtur minimalisht 0:1 nga Turqia në Prishtinë. Lidhur me të ardhmen e tij te Kosova, Muriqi ka folur për "La Zona 10". "Plani ishte të luaja në Kupën e

Botës dhe më pas të tërhiqesha. Këtë ua kam thënë presidentit dhe trajnerit", ka deklaruar Muriqi. Megjithatë, ai ka theksuar se aktualisht nuk dëshiron të fokusohet në këtë çështje, pasi prioritet mbetet përfundimi i sezonit me klubin e tij në Spanjë. "Nuk kam menduar për këtë. Po përpiqem të mos mendoj sepse dua të përqendrohem tek ajo që ka mbetur me Mallorcan. Më vonë

do të kem kohë të mendoj", ka thënë ai. Muriqi ka konfirmuar se vendimi përfundimtar ende nuk është marrë, duke nënvizuar se gjithçka do të peshohet me kujdes në bashkëpunim me familjen e tij. "Nuk kam marrë asnjë vendim. Kam biseduar me gruan dhe familjen time dhe duhet ta peshoj mirë. Ende nuk kam vendosur", ka thënë Muriqi.

## Lewandowski drejt Milanit

**BARCELONË, 11 PRILL** - Sulmuesi polak 37-vjeçar Lewandowski i është ofruar Milanit si përforsim për sezonin e ardhshëm. Kontrata e tij me Barcelonën skadon në verë, që do të thotë se ai mund të

mbërrijë në "San Siro" pa një klauzolë lirimi. Në një kohë kur Milani po kërkon një sulmues të fortë për t'i rritur ambicien, mbërritja e njërit prej golashënuesve më të mirë të gjeneratës së tij

përfaqëson një mundësi joshëse, shkruan "Gazzetta.it". Pas Borussia Dortmundit, Bayernit dhe Barcelonës, Lewandowski dëshiron një tjetër sfidë në një nga klubet e mëdha evropiane, e Milani po

shfaqet si një destinacion tërheqës. Agjentët e tij po eksplorojnë në mënyrë aktive mundësitë, dhe Milani, i cili dëshiron të kthehet në krye të Evropës, përshtatet në mënyrë të përkryer në këto plane.









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
®  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

